

FJALA E DEPUTETIT ILIR NDRAXHI

E ENJTE 14 PRILL 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit” ka si qëllim përcaktimin e parakushteve për krijimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit. Ai përcakton parimet bazë, standardet, përgjegjësitë dhe proceset për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit; hartimin e zbatimit e strategjive të zhvillimit të udhëhequra nga komuniteti, në harmoni me politikat e zhvillimit bujqësor dhe rural. Grupet vendore të veprimit do të mundësojnë përmes partneritetit lokal dhe parimit nga poshtë-lart përfshirjen e komuniteteve lokale në identifikimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit rural të udhëhequra nga vetë komuniteti në varësi të nevojave të tyre, marrjen e vendimeve për alokimin e burimeve të tyre financiare dhe menaxhimin e tyre bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, sigurimin e një mjedisi për investimet në zonat rurale nga vetë komuniteti, ngritjen e kapaciteteve vendore, si dhe zbatimin e strategjive lokale të zhvillimit përmes projekteve lokale.

Sipas këtij projektligji, parashikohet krijimi i grupeve vendore të veprimit, të cilat do të jenë organizma jofitimprurëse me bazë partneriteti, të përbërë nga përfaqësues të interesave lokalë, publikë dhe privatë, ku në nivelin e vendimmarrjes, asnjë autoritet publik ose grup interesi nuk përfaqëson më shumë se 49% të të drejtave të votës. Aktualisht Shqipëria ka akses në fonde direkte nga BE-ja, fonde që janë 90% grant nga BE-ja dhe 10% nga qeveria shqiptare. Grupet vendore të veprimit mund të aksesojnë fonde deri në 100% për projekte që ata i shohin të natyrës së përbashkët në komunitetet e tyre. Fusha e veprimit është mbështetja e rritjes ekonomike, sociale dhe kulturore e komuniteteve të zonës “lider” përmes rritjes së vlerave të burimeve lokale dhe aseteve, si dhe përmes hartimit, zbatimit të strategjisë së zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti.

Roli i Ministrisë së Bujqësisë, sipas këtij projektligji, është krijimi i regjistrit të grupeve vendore të veprimit, të cilat do të regjistrohen fillimisht në gjykatë, më pas në regjistrin përkatës të Ministrisë së Bujqësisë, pasi të verifikohen kriteret që duhen përmbushur për t’u regjistruar si grup vendor veprimi. Pjesë përbërëse e grupeve vendore të veprimit do të jenë organizatat profesionale, njësitë e vetëqeverisjes vendore, ofruesit e shërbimeve në komunitet, aktorë të tjerë lokalë, të cilët bëhen bashkë për të adresuar problematika që i përkasin një komuniteti të caktuar. Në aspektin organizativ grupet vendore të veprimit do të përbëhen nga organet drejtuese që janë: asambleja e përgjithshme, bordi dhe strukturat ekzekutive. Aktualisht, veprojnë dhe funksionojnë disa grupet vendore veprimi, të cilat quhen grupe lokale të veprimit. Krijimi dhe funksionimi i tyre është bërë në partneritetet me rrjetin e zhvillimit rural, duke përfituar edhe fonde nga donatorët ndërkombëtarë.

Grupet vendore të veprimit,, që krijohen sipas këtij projektligji, mund të ndërveprojnë mes tyre për interesa të përbashkëta të territoreve që përfaqësojnë, por edhe me grupet vendore të shteteve të tjera

për realizimin e projekteve konkrete. Instrumentet financiare për financimin e grupeve vendore të veprimit, të cilat miratohen nga asambleja e përgjithshme përfshijnë: tarifën e anëtarësisë; grante nga programi IPARD; grante nga programe të tjera publike qendrore apo vendore; kredi; skema garancie; pjesëmarrje me aksione, si dhe partneritete publike-private. Projektligji përafrohet pjesërisht rregulloret e Bashkimit Europian. Gjatë fazës së hartimit të tij projektligji është konsultuar me grupet e interesit, me Rrjetin Shqiptar të Zhvillimit Rural (ANRD), konsulentë të FAO-s, Universitetin Bujqësor, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Në përfundim, duke e vlerësuar si pozitiv projektligjin e propozuar, theksoj rëndësinë që do të ketë miratimi i tij për zhvillimin e hapësirës rurale, nëpërmjet përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjet lidhur me seleksionimin e përzgjedhjen e projekteve; monitorimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit lokal të udhëhequra nga vetë komuniteti; forcimin e llogaridhënies për vetëqeverisjen lokale, pasi një grup i caktuar vendor është në gjendje të kërkojë një llogaridhënie më të posaçme për çështje të caktuara; integrimin e territoreve urbane, periferike dhe rurale, duke inkurajuar kështu përfshirjen e të gjithë aktorëve lokalë; krijimin e mundësive më të mira për shkëmbimin dhe përhapjen e informacionit dhe teknologjinë në komunitetet më të larta rurale, si dhe përafrimin me politikën e përbashkët europiane, duke na mundësuar kështu akses në fondet e BE-së nëpërmjet programit IPARD. Ftoj kolegët për miratimin e këtij projektligji! Faleminderit!